

Incidente zgjedhore

Rastet e incidenteve të bera publike gjatë fushatës së zgjedhjeve lokale 2023

- [Vau i Dejës](#)
- [Lezhë](#)

Vau i Dejës

Më datë 11 Prill 2023 një incident i rëndë ka ndodhur para hapjes zyrtare të fushatës. Makina e kreut të Partisë Demokratike në Vaun e Dejës, Bernard Ndreca është hedhur në erë me një sasi tritoli. Ky i fundit është zgjedhur kryetar i PD-së për Vaun e Dejës, pas zgjedhjeve të Rithemelimit, dhe ka qenë në krah të kandidatit Zef Hila për zgjedhjet e ardhshme të 14 Majit. Si pasojë e shpërthimit të makinës ka vetëm dëme materiale. Burime bëjnë me dije se mjeti ka shpërthyer sapo Ndreca ka hipur ne makinë, por fatmirësisht nuk ka pësuar lëndime. Vau i Dejës është një nga bashkitë e pakta ky opozita e përçarë kandidon me dy emra. Nga Rithemelimi kandidon Zef Hila, i cili ka mbajtur dhe mandatin e deputetit, si dhe ka qenë më herët në krye të Bashkisë. Dhe nga ana tjetër kandidon Klomentina Drini, e cila nuk ka marrë as mbështetjen e kandidatëve për këshilltarë bashkiakë, të propozuar në listë nga PD-ja zyrtare

Lezhë

Biznesmeni Ardian Nikulaj, i cili ushtronte veprimtarinë e tij në fushën e hoteleri-turizmit, u vra të më datë 19 prill 2023 në qytetin e Shëngjinit. Ai ndodhej në mjediset e brendshme të resorit në pronësi të tij “Coral Shëngjin”, në Shëngjin kur u qëllua. 51-vjeçari Ardian Nikulaj rezulton se ka disa biznese në zonën e Lezhës dhe ka qenë gjithashtu pjesë e politikës. Aktualisht ai garonte në listën e anëtarëve të Këshillit Bashkiak dhe më parë ka kandiduar për deputet në Lezhë në listën e PSD-së.